

| INFORMATA PËR PRINDËR

Orari i vizitave





Këndshëm, që Ju vini në vizitë

Prindërit, motrat dhe vëllezërit si dhe vizitorët tjerë të pacientëve tonë janë përzemërsisht të mirëseardhur në spitalin tonë për fëmijë në Cyrih. Kontakti me familjarët dhe rrethin e tyre social është i rëndësishëm për fëmijët dhe të rinjtë e sëmurë dhe ky duhet të garantohet edhe gjatë qëndrimit të tyre në spital. Ju lutem vini re, që repartet e ndryshme të spitalit tonë kanë kohëra specifike të vizitave.

Koha e vizitave për prindër

Prindërit i përkasin fëmijës - ata sipas pikëpamjeve tona nuk janë vetëm vizitorë.

Kohërat e vizitave të pacientëve për prindër dhe motra e vëllezër parimisht janë të lira. Në marrëveshje me infermieret mund të përcaktohen edhe persona tjerë referues për fëmijën apo të riun, për të cilët do të vlen rregullorja e njëjtë. Bisedat eventuale me mjek apo me infermieret gjatë vizitës tuaj ju lutemi të i paralajmëroni më parë.

Koha e vizitave për vizitorët tjerë

Koha e vizitës është prej orës 14:00 deri në ora 20:00. Ne ju lusim, që dëshirat individuale të i aranzhoni me infermieret dhe të i përmbaheni rregulloreve të reparteve të veçanta. Fatkeqësisht ne nuk mund të e përjashtojmë mundësinë, që për shkak të ekzaminimeve dhe terapisë mund të vjen deri te pritja. Vizitat e klasave shkollore apo të miqve me grupe duhet të organizohen përmes infermieret.

Ju lutemi keni konsideratë

Koha e vizitave i përshtatet moshës dhe gjendjes shëndetësore të pacientëve tonë. Keni mirëkuptim, nëse numri i vizitorëve apo koha e vizitës kufizohet për shkak të gjendjes shëndetësore të pacientit, masave të përkujdesjes apo të hapësirës së kufizuar. Keni konsideratë që pacientët kanë më shumë nevojë për pushim.

Ju lutemi vini re

Vizitorët – edhe prindërit dhe motrat e vëllezërit – duhet të jenë të shëndoshë dhe nuk guxojnë të kishin pasur kontakte me persona me sëmundje ngjitëse. Po që se vizita personale nuk është e mundur, përdorni mundësitë tjera të kontaktimit. Në spitalin për fëmijë ju qëndron në dispozicion një WLAN.

Shërbimi i kujdesit për fëmijë


Prej të Hënës deri të Premten prej orës 13:30 deri 16:00 për motrat dhe vëllezërit e pacientëve dhe fëmijët e vizitorëve (prej 3 vjeç e më lartë) përkujdesen kujdestaret vullnetare. Shërbimi për përkujdesje të fëmijëve gjendet pranë hyrjes kryesore.

Përcaktimi i grupit të personave i referohet gjithnjë të dy gjinive

Kontakti

Centrali i telefonit +41 44 266 71 11

Për rregulloret specifike në reparte
ju informon me dëshirë personeli
kujdestarë.



- Stacioni kryesorë: → **Tram 3** Drejtimi Klusplatz deri te stacioni Hottingerplatz*
 → **Tram 6** Drejtimi Zoo deri te stacioni Platte*
 Stadelhofen: → **Tram 8** Drejtimi Klusplatz deri te Römerhof*

*Nga këto stacione spitali i fëmijëve gjendet rreth 10. min larg në këmbë.